



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 4145/Prot.  
6

Pogradec, më 14.10 2024

VENDIM

Nr. 112, DATË 11.10.2024

“PËR  
SHFRYTËZIMIN DHE PËRDORIMIN E SASISË SË MATERIALIT DRUSOR PREJ  
551 MST (DRU ZJARRI), NË GJËNDJE TË MAGAZINUAR NË FUSHËN E BASHKISË  
POGRADEC, ME QËLLIM POLTËSIMIN E NEVOJAVE PËR NGROHJE ENTEVE  
PUBLIKE SI: (SHKOLLA, KOPSHTË, ÇERDHE).

Të nderuar këshilltarë !

Në mbështetje të; pikes 2 të nenit 8, pike 5 të nenit 27 të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendor”, Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit Nr.57/2020, “Për Pyjet”, Vendimit të Këshillit të Ministrave VKM Nr.438, datë 08.06.2016 “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore dhe jo pyjore”, Ligjit Nr.10296, date 08/07/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” ( i ndryshuar), Ligjit Nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësinë e sektorit publik”. Bashkia Pogradec me propozim të Kryetarit të Bashkisë dhe Drejtorisë së Shërbimit Mbrojtjes së Pyjeve dhe Kullotave pasi u shqyrtua relacioni i përgatitur nga Administrata e Bashkisë ku është argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, i kërkohet Këshillit Bashkiak të Bashkisë Pogradec që në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_.2024 të miratojë:

**VENDOSI:**

1. Të miratojë përdorimin e sasisë së materialit drusor prej 551 mst të llojit pyjor Ah dhe Lis për plotësimin e nevojave me dru zjarri entet Publike (Shkolla, Kopshte, Çerdhe etj).
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Pogradec, Drejtoria e Shërbimit Mbrojtjes së Pyjeve dhe Kullotave, Drejtoria e Çështjeve Juridike, Drejtoria



Ekonomike dhe Menaxhimit Financiare.

3. Ngarkohet komisioni I shërbimeve publike, transportit , lëvizshmërisë mjedisore, parqeve dhe rekreacionit, parkingjeve, I zhvillimit hapësinor, infrastrukturës dhe strehimit për monitorimin e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
5. U shpall sot më datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024.

**KRYETARE E KËSHILLIT**

Manjola KAMOLLI



1.Miratuar me 18 vota

2.Vota Pro 18

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 14, 10, 2024